



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
*Sesioni vjeshtor*

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

Mbledhja nr. 31 .

Prishtinë, më 28.1.2019, në ora 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Slobodan Petroviç dhe Veton Berisha, anëtarë.

**Munguan:** Igor Simiq, Jasmina Zhivkoviç, Sasha Milosavljeviç, Zoran Mojsiloviç dhe Duda Balje .

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetovic, OSBE: Pleurat Kurti, EUSR; Hajrudin Skënderi Ambasada e Suedisë; Ndriçim Çekaj, KDI; Zijush Ahmeti, KSZ dhe Celal Iliaz, Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i Komisionit.

**Rend i ditës:**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 12.12.2018 dhe 20.12.2018;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2018;**
4. **Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për vitin 2019;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2019, me raport amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa;**
6. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

**Kryetari**, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 12.12.2018 dhe 20.12.2018.**

**Zëvendëskryetari**, konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 12.12.2018 dhe 20.12.2018, pa vërejtje.

### 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2018.

**Xhelal Sveçla, zëvendëskryetar,** u shpreh se para vetes kemi raportin e punës për vitin 2018, ku janë përfshirë të gjitha aktivitetet, në kuadër të organizimit të brendshëm dhe procedurat e funksionimit të mbarëvajtjes së punës së komisionit, për vitin 2018.

Pasi nuk pati diskutime shtesë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

#### **Përfundim**

*Komisioni miratoi njëzëri Raportin e punës së Komisionit, për vitin 2018.*

### 4. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për vitin 2019.

**Zëvendëskryetari,** theksoi se Kryesia e Kuvendit, në bazë të nenit 67.6 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 15 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 18 janar 2019, ka shqyrtuar Programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për vitin 2019. Me këtë rast, ka dalë me përfundimin se komisionet parlamentare, duhet të hartojnë planet e punës periodike dhe programin e punës së komisioneve, deri më 31 janar 2019.

Gjatë ushtrimit të punëve të përcaktuara, komisioni do të shqyrtojë draft-planin e punës, i cili është udhërrëfyes i punës dhe aktiviteve, që ndërliken me përgjegjësitë e Komisionit.

Ai tha se ky plan nuk i përfshin të gjitha aktivitetet për vitin kalendarik. Komisioni duhet të realizojë çdo muaj nga dy vizita në terren, me mundësi të caktohen takime me kryetarët e komunave, të vihen kontakte me qytetarët, me grupet e interesit, institucione të ndryshme dhe me organizatat joqeveritare. Gjithashtu, një herë në muaj, të ftohen në raportim ministrat e resorëve përkatës.

Në javën e parë të muajit shkurt, të realizohet vizita në KK të Zubin Potokut, pas dy jave në KK të Leposaviqit, çështje kjo e cila është në interes për zhvillimin e procesit të dialogut, dhe veçmas akomodimi i kërkesave të komuniteteve tjera.

Ai kërkoi nga anëtarët e komisionit të japin sugjerimet e tyre në draft - planin e punës, me qëllim që i njëjti të plotësohet dhe të miratohet në këtë takim.

**Veton Berisha,** u pajtua me propozimet e dhëna dhe ai propozoi që të shtohet si pikë: planifikimi i aktiviteve edhe me mekanizma tjerë që ndërliken me çështjen e komuniteteve, siç janë: Zyrat Komunale për Komunitete, Zyra për Komunitete pranë Zyrës së Kryeministrit dhe Këshillin Konsultativ për Komunitete, pranë Zyrës së Presidentit, që duhen të raportojnë për planin dhe zhvillimet e punës së tyre.

**Kujtim Shala,** tha se sipas agjendës së pacaktuar, komisioni duhet të miratojë Planin e punës për vitin 2019, në parim dhe propozoi që komisioni të caktojë një takim në muajin shkurt, me mundësi që i njëjti të plotësohet dhe ndryshohet.

**Zëvendëskryetari,** tha se Komisioni ka kompetencë që periodikisht të kontrollojë planin e vetë të punës dhe aktivitetet dhe të njëjtat t'i harmonizojë me kërkesat dhe nevojat.

Në bazë të këtyre kompetencave, propozoi që Komisioni të organizojë një punëtori, brenda territorit të Kosovës, në javën e parë të muajit shkurt.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë

## **Përfundim**

*Komisioni miratoi Planin e punës për vitin 2018, me arsyetimin që të plotësohet me pikën si në vijim :*

*Në javën e parë të muajit shkurt, Komisioni do të organizojë punëtorinë, me qëllim që të ndryshohet dhe plotësohet Plani i punës së për vitin 2019, në bashkëpunim me administratën dhe misionin e OSBE-së.*

### **5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2019, me raport amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa.**

**Zëvendëskryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2019 dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen, nëse ka ndonjë propozim apo sugjerim në Projektligj dhe raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

Komisioni do të shqyrtojë Projektligjin dhe raportin e Komisionit Funksional për buxhet dhe financa, dhe veçmas do ti shqyrtojë propozim- amendamentet e dhëna nga disa anëtarë të komisionit, pasi shumica prej tyre nuk e kanë marr përkrahjen nga Komisioni Funksional.

Zëvendëskryetari, fillimisht hodhi në votim propozimet e dhëna të deputetes Duda Balje dhe Bahri Shabani.

Pas diskutimit, u konstatua se Komisioni miratoi të njëjtat me 5 vota Për, 3 Kundër dhe 1 Abstenim.

Zëvendëskryetari, dha për shqyrtim amendamentin 100, me dy propozime, dhe hapi debatin për këtë pikë.

**Danush Ademi** dhe **Mufera Shinik**, propozuan të caktohet një takim për ditën e nesërme, në orën 9:30, me qëllim të mirën sqarimet e duhura në lidhje me amendamentin 100 A), nënparagrafi 1 dhe 2, dhe amendamentin B) të propozuar nga GP 6+.

**Kujtim Shala**, dha sqarime shtesë. Amendamenti 100, ka të bëjë me ndryshimin e emërimit: në paragrafin 1, bëhet fjalë për “projektin për mbështetje të komuniteteve”, ku ndryshohet shuma 0 dhe shtohet projekti i ri “projektin për komunitetet e GP 6+” në shumë prej 2,500,000 euro, dhe se 700, 000 euro rrjedhin si burim i financimit nga të hyrat e AKP-së.

Sa i përket, paragrafit 2, bëhet fjalë për “projektin e komuniteteve tjera” në vlerë prej 1.200.000 euro. Ndërsa, sa i përket propozimit të GP 6+ , i njëjti është përfshirë në amendamentin 100 A). Në fund, tha se ndarja buxhetore e të dy paragrafëve, është e qartë.

Pas këtyre sqarimeve, Danush Ademi dhe Mufera Shinik, u deklaruan se do të votojnë Ligjin në tërësi dhe raportin me amendamente të Komisionit Funksional.

**Veton Berisha**, shprehu qëndrimin e tij se komunitetet duhet të referohen, siç është e caktuar me Kushtetutë. Sa i përket projektit të propozuar nga GP 6+, mirë është të shtjellohet çështja se cilat komunitete do të jenë përfitues me këtë projekt.

**Berisha**, konsideron se amendamenti 100 A) paragrafi 1, mjetet janë dedikuar për Komunitetet e GP 6+ , ku nuk bënë pjesë komuniteti egjiptian. Në këtë rast, është në rregull me komunitetin egjiptian ngase kërkesat e veta i realizon në kuadër të këtij buxheti.

Ai propozoi që amendamenti 100 A) paragrafi 1.2, të riformulohet me tekstin si në vijim:

Në Organizatën Buxhetore ‘‘Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale’’, me kod organizativ 209, në nënprogramin ‘‘Institucionet’’ 00700, në kategorinë e ‘‘shpenzimeve kapitale’’ në tabelën 3.2 të shtohet projekti i ri ‘‘Projekti për komunitetet joshumicë dhe jo serbe’’ të cilët nuk janë pjesë e GP 6+ dhe GP të Listës Serbe’’ në shumë prej 1,200,000 euro.

Përveç amendamentit të paraqitur, ai propozoi edhe amendamentin tjetër, si në vijim: ‘‘në tërë tekstin e Projektligjit, të fshihet shkurtesa ‘‘RAE’’ dhe të zëvendësohet me fjalën ‘‘ për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian’’. Me theks të veçantë, tha se nëse nuk miratohen këto propozime, unë nuk do ta votojë Projektligjin mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.

**Berisha**, theksoi se në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, vitin e kaluar, iu është ndarë buxhet në vlerë prej 1.900.000 mijë euro, Gjithashtu, ekziston një raport të cilin nuk e kanë realizuar, në vitin paraprak. Edhe në këtë vit, iu është nda buxhet i njëjti në këtë Ministri, të cilin buxhet e shfrytëzon për projekte të interesave të tyre dhe se nuk i dedikon për komunitetet tjera, për çka dhe janë të thirrur në mandatin e tyre. Vërejtja e tij ishte se ende ka refugjatë të komunitetit egjiptian në Mal të Zi, Maqedoni dhe Serbi, Edhe për kundër faktit se ekziston vullneti i plotë i tyre që të kthehen në Kosovë, por mungon iniciativa e ministrisë për ti kthyer, dhe kjo situatë për ne është e papranueshme. Andaj, kërkoi që ky komision ti vizitojë refugjatët në këto rajone, me mundësi që të shtyhet përpara procesi i kthimit.

**Albert Kinolli**, sa i përket propozim amendamentit 100 A), është iniciuar nga GP 6+. Për hir të korrektësisë dha shpjegime të hollësishme se kemi pasur takime të përbashkëta me ministrin për Financa dhe Buxhet z. Bedri Hamza, dhe jemi akorduar me formulën, që secili përfaqësues i GP 6+ të marrë pjesën që i takon. E them këtë se në vitin e kaluar, projekti ka qenë i dedikuar për komunitetet, pra, nuk ka qenë i precizuar për cilat komunitete dhe mjetet janë kthye si deficit, në Qeveri. Tani është arritur marrëveshjen, që veçmas të jetë ‘‘Projekti për komunitetet e GP 6+’’ në shumë prej 2,500.000 euro, dhe nën 2, ‘projekti për komunitetet tjera’ projekt ky i cili nuk përfshihen përfaqësuesit e GP 6+. Për arsyet e lartë cekura, GP 6+ tërhiqet nga propozimi amendamenti B) pasi i njëjti është përfshi në amendamentin 100 A) paragrafi 1.

*Pas përfundimit të diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni i miratoi unanimitet dy propozim-amendamentet e deputetit Veton Berisha, ndërsa nuk e miratoi propozim-amendamentin 100 B).*

Zëvendëskryetari, raportoi se amendamenti 101, i propozuar nga deputeti Slobodan Petroviq, ka marrë përkrahjen e plotë të Komisionit FunkSIONAL.

**Slobodan Petrovic**, tha se po diskutohet për çështjet të cilat janë shumë të qarta. Po flisni një histori të njëjte nga dy këndvështrime të ndryshme. Dihet se përfaqësimi i komunitetet joshumicë tjera, është kategori Kushtetuese, ku çdokush gëzon të drejtën e barabartë, pa diskriminim. Unë jam përfaqësues i komunitetit serb dhe konsideroj se asnjë parti politike, nuk mund të vendos për të drejtat e mia, dhe ky është thelbi që edhe ju të mos bini pre e ndikimeve politike.

**Rasim Selmanaj**, theksoi se ka propozuar amendamentet 128 dhe 129, dhe asnjëri nuk është përkrahur nga Komisioni FunkSIONAL.

Ai kërkoi përkrahjen e Komisionit, për propozim- amendamentin 128: Në Organizatën buxhetore ‘Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve’ me kod organizativë 207, bëhen ndryshimet si në vijim:

1.1 Në tabelën 3.2, nënën paragrafin 207100-Sportet, 80200-Arritjet sportive, shtohet projekt i ri, ‘Fusha Sportive në Shaptaj, Deçan, në shumë prej 50.000 euro’.

Ai, tërhoqi propozimin për amendamentin 129, lidhur me projektin e ri : Memoriali në qytetin e Deçanit, në vlerë prej 30,000 euro.

*Pas diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni me votë unanime, miratoi amendamentin 128 të deputetit Rasim Selmanaj, ndërsa nuk mori përkrahje amendamenti 129.*

Zëvendëskryetari, dha në shqyrtim amendamentin 146, të propozuar nga Veton Berisha. Pas diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni nuk përkrahu amendamentin 146.

Zëvendëskryetari, dha në shqyrtim amendamentit 147, të propozuar nga deputeti Albert Kinolli. Pas konsultimeve, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi amendamentit 147.

Zëvendëskryetari, dha në shqyrtim amendamentin 148, të propozuar nga deputeti Danush Ademi. Pas konsultimeve, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni njëzëri miratoi amendamentin 148.

*Pas përfundimit të diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, u pajtua unanimitisht të miratohet Projektligji dhe raporti me amendamente i Komisionit funksional, dhe nxori këtë:*

### **Rekomandim**

- I. Projektligji nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Komisioni ka shqyrtuar amendamentet e propozuara të Komisionit funksional dhe ka përkrahur amendamentin 84 B, amendamentin 128, 147 dhe 148, ndërsa nuk e ka përkrahur amendamentin 100 propozimi A).
- III. Rekomandohet propozimi për ndryshim:

#### **Amendament 1**

Në pjesën tabelore të Projektligjit, amendamenti 100, propozimi A) i Komisionit funksional, në Organizatën Buxhetore ‘Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me kod organizativ 209, paragrafi 1.2 riformulohet si në vijim:

*Në nënprogramin “Institucionet” 00700, në kategorinë e “shpenzimeve kapitale” në tabelën 3.2 shtohet projekti i ri “Projekti për komunitetet joshumicë dhe jo serbe” të cilët nuk janë pjesë e GP 6+ dhe GP të Listës Serbe” në shumë prej 1,200,000 euro.*

#### **Amendamenti 2**

Në tërë tekstin e Projektligjit, të fshihet shkurtesa ‘‘RAE’’ dhe të zëvendësohet me fjalën ‘‘ për komunitetin Rom, Ashkali dhe Egjiptian’’.

*Mbledhja përfundoi në orën 13:30.*

*E përgatiti ; Staf i mbështetës i Komisionit.*

**Nënkryetar i Komisionit,**

---

**Xhelal Sveçla**